



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 40 paragrafi 2 nën paragrafi d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 40 paragrafi 2 nën paragrafi 4) të Statutit të Komunës së Klinës 2010, me Rekomandimin e Komitetit për Politik dhe Financa të datës: 13.01.2023, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e I-rë të rregullt për vitin 2023, të mbajtur me datën: 27.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

Për miratimin e planit të punës së ekzekutivit për vitin 2023

1. Miratohet Plani i Punës së Ekzekutivit për vitin 2023.
2. Plani i punës përcakton aktivitetet që do të ndërmerren gjatë vitit ku puna e ekzekutivit ndërlidhet me dokumentet strategjike të nxjerra nga kuvendi komunal. Kompetent për ekzekutimin e këtij Plani është ekzekutivi i Komunës.
3. Pjese përbërëse e këtij vendimi është Plani i Punës së Ekzekutivit për vitin 2023
4. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës konform nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale
5. Me këtë vendim njoftohet: MAPL, Kryetari i Komunës, Ekzekutivi i Komunës, Zyra për Informim, dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-3588 /2023
Klinë, me 31. 01 /2023



Kryesuesi
Fadil Gashi